



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2021:193629
Datë: 03.10.2024
Numri i dokumentit: 06245541

K.DH.SH.II.nr.1224/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkalles se Dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami, ne çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Beni Dona Plast sh.p.k, me nr. unik identifikues 810545981, me seli në Prishtinë, Lagjia “Ulpiana” rr. “Imzot Nikë Prela” p.n, që sipas autorizimit përfaqësohet nga Jeton Berisha, kundër debitorit Komuna e Kamenicës, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm, KPPP.nr.2164/23 të datës 26.04.2024, me datën 02.10.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET si e bazuar ankesa e debitorit Komuna e Kamenicës, **NDRYSHOHET** aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.2164/23 të datës 26.04.2024, ashtu që çështja gjykohet si në vijim: **APROVOHET** si i bazuar prapësimi i debitorit Komuna e Kamenicës, i ushtruar kundër Urdhrit mbi lejimin e përmbartimit P.nr.1143/21 dt.19.07.2021, **ANULOHET** Urdhri përmbartimor P.nr.1143/21 dt.19.07.2021, i Përmbartuesit Privat Isa Gacaferri, për territorin e Gjykatës Themelore ne Prishtinë.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.2164/23 të datës 26.04.2024, ka refuzuar si ta pa bazuar prapësimin e debitorit Komuna e Kamenicës i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 1143/21 të datës 19.07.2021, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Isa Gafaceri.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë debitori, për shkak te shkeljes se dispozitave te procedurës kontestimore dhe asaj përmbartimore, konstatimit te gabuar

apo jo te plote te gjendjes faktike dhe zbatimit te gabuar te se drejtës materiale, me propozim qe gjykata e shkallës se dytë ta aprovoj ne tërësi këtë ankesë, aktvendimi i ankimuar te priset dhe çështja te kthehet shkalles se parë ne rishqyrtim dhe vendosje.

Kreditori ka parashtruar përgjigje në ankesë nëpërmjet të cilës ka kërkuar që të refuzohet ankesa e debitorit si e pabazuar, ndërsa Urdhri Përmbarrimor P.nr. 1143/21 të datës 19.07.2021, i lejuar nga Përmbarruesi Privat Isa Gafaceri të mbetet në fuqi.

Dhoma e Shkallës se Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbarrimore (LPP), gjeti se:

- **Ankesa e debitorit është e bazuar.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se Përmbarruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Beni Dona Plast sh.p.k, me datë 19.07.2021 ka lëshuar urdhrin P.nr.1143/2021, duke lejuar përmbarrimin në bazë të dokumenteve: faturë nr. 17/21 IQ e datës 23.04.2021, faturë nr. 18/21 S e datës 23.04.2021, faturë nr. 19/21 AP e datës 23.04.2021, faturë nr. 20/21 b e datës 23.04.2021 dhe faturë nr. 21/21 G e datës 23.04.2021, ashtu që është urdhëruar debitori Komuna e Kamenicës, që në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturave të lartcekura t'ia paguaj kreditorit shumën prej 1,015.65 € (njëmijë e pesëmbëdhjetë euro e gjashtëdhjetë e pesë euro cent) me kamatë ligjore prej 8% nga dita e arritjes për pagesë e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës përmbarrimore.

Gjykata Themelore në Gjilan – Dega në Kamenicë, me aktvendimin PPP.nr. 13/2021 të datës 23.06.2022 ka refuzuar në tërësi prapësimin e debitorit Komuna e Kamenicës ndërsa ka lënë në fuqi Urdhrin Përmbarrimor P.nr. 1143/2021 të datës 19.07.2021. Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë, me aktvendimin K.DH.SH.II.nr. 384/23 të datës 30.10.2023 ka aprovuar në tërësi ankesën e debitorit Komuna e Kamenicës ashtu që ka anuluar aktvendimin PPP.nr. 13/2021 të datës 23.06.2022 të Gjykatës Themelore në Gjilan – Dega në Kamenicë, ndërsa lëndën e ka kthyer në rivendosje pranë Dhomave të Shkallës së Parë të Gjykatës Komerciale. Me qëllim të shqyrtimit të validitetit të prapësimin të debitorit,

Gjykata, në rivendosje, në kuptim të nenit 73, par.1 të LPP-së ka caktuar seancën dëgjimore lidhur me këtë çështje përmbarrimore me datë 03.04.2024, dhe e cila seancë, është shtyrë me kërkesën e përfaqësuesit të debitorit, i cili ka njoftuar gjykatën se në të njëjtën datë dhe orë është i angazhuar në një seancë tjetër kontestimore. Gjykata, ka ri caktuar seancën dëgjimore me datë 25.04.2024, për të cilën seancë, përfaqësuesi i debitorit përsëri ka dorëzuar parashtrësë për shtyrje të seancës, tanimë me arsyetimin se në datën e kësaj seance i njëjti gjendet në pushim vjetor, duke bashkangjitur kështu vendimin për pushim vjetor për periudhën 15.04.2024 deri më 30.04.2024.

Gjykata, me aktvendim procedural të dhënë përgjatë seancës, kërkesën e debitorit për shtyrjen e seancës së datës 25.04.2024 e ka refuzuar si të pabazuar kjo për faktin debitori, ka pranuar njoftimin për ri caktimin e seancës dëgjimore me datë 04.04.2024, fakt ky që vërtetohet nga flet kthesa e Postës së Kosovës pjesë e shkresave të lëndës, andaj fakti që debitori si institucion publik i ka dhënë prioritet trajtimit të kërkesës për pushim të përfaqësuesit të debitorit, duke qenë në dijeni se seanca dëgjimore në këtë çështje është caktuar pikërisht në periudhën kohore kur përfaqësuesi i debitorit ka kërkuar marrjen e pushimit, i mbetet në barrë palës debitore dhe si e tillë nuk paraqet shkak për shtyrjen e kësaj seance.

I autorizuari i kreditorit, përgjatë seancës dëgjimore ka deklaruar se mbet në tërësi pranë propozimit për përmbarrim me numër 1143/21 e datës 19.07.2021, për faktin se propozimi është parashtruar në bazë të dispozitave ligjore respektivisht nenit 29 par.1 pika 1.3 dhe paragrafi 3 dhe se i njëjti nuk ka asnjë arsyeje objektive që të refuzohet si i pa bazuar. Ka shtuar se faturat objekt i këtij përmbarrimi përveç që përmbajnë nënshkrimin e debitorit të njëjtat i janë dërguar edhe me postë elektronike ne përputhje me nenin 6 të kontratës së lidhur mes palëve i cili ka paraparë mundësinë e komunikimit edhe përmes postës elektronike. Ka shtuar se me nenin 2 të kontratës është përcaktuar se vendi i dorëzimit të furnizimit do të jetë në njësitë shpenzuese ne Komunën e Kamenicës, andaj mbi bazën e kësaj rezulton se edhe fatura është dorëzuar në momentin e dërgimit të mallit dhe është pranuar nga personat që kanë pranuar këtë mall pa kurrfarë vërejtje, ndërsa debitori, edhe në të kaluarën ka bërë pagesa për kreditorin lidhur me fatura të pranuar në të njëjtën formë, pa vulë të protokollit.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm, pas vlerësimit të prapësimit dhe përgjigjes ne prapësim, si dhe përgjatë seancës dëgjimore të datës 25.04.2024, ka nxjerrë aktvendimin KPPP.nr.2164/23 të datës 26.04.2024 me të cilin ka refuzuar si ta pa bazuar prapësimin e debitorit Komuna e Kamenicës i paraqitur kundër Urdhrit Përmbarrimor P.nr. 1143/21 të datës 19.07.2021, të lejuar nga Përmbarruesi Privat Isa Gafaceri. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar ka theksuar se debitori është vënë në dijeni lidhur me faturat e lartcekura, fakt ky që vërtetohet nga nënshkrimi i vënë tek pranuesi i secilës faturë si dhe nënshkrimi i vënë në flete dërgesat e pranimit të mallit në emër të secilës faturë. Për më tepër, gjykata konstaton se faturat e lartcekura debitorit i janë dërguar edhe përmes postës elektronike me datë 07.08.2021, dhe atë në adresën e zyrës së prokurimit të debitorit, formë kjo e komunikimit të cilën palët e kanë paraparë me nenin 6 të kontratës nr. KM653-19-1446-1-2-1 të datës 24.04.2019 dhe se faturat e lartcekura, janë lëshuar lidhur me shërbimet të cilat janë objekt i kësaj kontrate dhe atë brenda vlefshmërisë kohore të kësaj kontrate.

Nisur nga një gjendje e tillë faktike e çështjes, Gjykata Komerciale –Dhoma e shkallës se dytë vlerëson se nuk mund ta pranoj përfundimin dhe qëndrimin juridik te gjykatës së shkallës së parë pasi gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të gabuar ashtu qe edhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të gabuar, prandaj Gjykata e shkallës e dytë ka vendosur që ta ndryshoj aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë.

Në këtë rast gjykata e shkallës së parë nuk ka shqyrtuar në mënyrë të drejte shkresat në lende, pasi që gabimisht ka konstatuar se faturat kontestuese plotësojnë kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm konform nenit 29 të LPP-së. Faktin se faturat kanë qenë të nënshkruara dhe debitori është vënë në dijeni lidhur me faturat kontestuese përmes komunikimit elektronik, Gjykata e Shkallës së Dytë me shikim nga shkresat e lëndës nuk ka vërejtur në asnjë mënyrë se debitori faturën e lartcekur e ka pranuar me email, përkatësisht në shkresa të lëndës nuk ekziston një konfirmim i tillë.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se fatura nr. 17/21 IQ e datës 23.04.2021, faturë nr. 18/21 S e datës 23.04.2021, faturë nr. 19/21 AP e datës 23.04.2021, faturë nr. 20/21 b e datës 23.04.2021 dhe faturë nr. 21/21 G e datës 23.04.2021 në bazë të së cilave është lejuar propozimi për përmbarrim nuk i plotësojnë kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se në rastin konkret nuk mund të vërtetohet që faturat janë pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, përkatësisht me asnjë provë nuk është dëshmuar se faturat janë dorëzuar te debitori pasi që të njëjtat nuk janë protokolluar në zyrën e pranimit të debitorit - Komuna e Kamenicës dhe nuk mbajnë vulën e pranimit - protokollimit dhe si të tilla nuk janë të përshtatshme për përmbarrim.

Gjykata vlerësoi faktin se faturat janë nënshkruar, mirëpo gjeti se faturat në rastin konkret i drejtohen Komunës së Kamenicës, andaj të njëjtat do të duhej t'i dorëzoheshin Komunës së Kamenicës si dhe të protokoloheshin pranë debitorit Komuna e Kamenicës.

Duke qenë se debitori nuk ka pranuar në mënyrë të rregullt faturat e lartcekura, si të tilla nuk mund të shërbejnë si dokument i besueshëm dhe nuk kanë tipare të përmbarrueshmërisë, përderisa njëra palë procedurale - debitori nuk ka pranuar një detyrim që rrjedh nga fatura.

Nga këto arsye, Gjykata Komerciale –Dhoma e Shkalles se Dytë vlerëson ndryshe gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale dhe gjënë se në rastin konkret plotësohen kushtet ligjore që aktvendimi i ankimuar të ndryshohet, të aprovohet prapësimi i debitorit si i bazuar dhe urdhri për lejimin e përmbarrimit nga ana e Përmbarruesit Privat Isa Gacaferri nga Prishtina të anulohet .

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 194, 208, 209 paragrafi 1 pika c) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,
Dhoma e Shkalles se Dytë
K.DH.SH.II nr.1224/24, me datë 02.10.2024

Gjyqtari,
Faton Bajrami